



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Vushtrri, më 06. 01. 2015
Nr. 07-111-704

Në mbështetje nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, në bazë të vendimit të këshillit drejtues të QKMF-ës Vushtrri, nr.912 dhe në bazë të vendimit të kryetarit të komunës, nr.1530/14 të datës 31.12.2014, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-Vushtrri**
- **I.Vendi i Punës:Mjekë të përgjithshëm –Doktor të mjekësisë**

Numri i ekzekutuesve(pozitave) tre(3).

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

- Ofrojnë shërbime shëndetësore në kuadër të kujdesit primar shëndetësor pranë QKMF,QMF dhe ASH;
- Ofrojnë diagnostifikimin dhe menaxhimin efektiv të pacientëve duke siguruar edhe referimin në institucionet gjegjëse shëndetësore.);
- Të kenë vetiniciativë dhe ti përmbahen etikës mjekësore dhe kodit të mirësjelljes ;
- Të mbikëqyrin dhe menaxhojnë punën e infermierëve dhe të stafit tjetër përcjellës në QKMF,QMF dhe ASH.;
- Kryejnë të gjitha punët e mjekut nga lëmi i mjekësisë familjare;
- Për punën e vetë i përgjigjen shefit të mjekësisë familjare;
- Të jenë të gatshëm të punojnë në grupe në situata të jashtëzakonshme;
- Të kenë vetiniciativë dhe të i përmbahen etikës mjekësore;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

-Të ketë të kryer Fakultetin e Mjekësisë-Drejtimi i përgjithshëm

-Të kenë të kryer stazhin e obliguar sipas ligjit dhe të jenë të licencuar.

Periudha e kontratës:

Një vit punë provuese me mundësi vazhdimi .

Paga:Koeficienti 7.20

Orët e punës :40

II.Vendi i punës:Farmacist i diplomuar-Magjistër i farmacisë

Numri i ekzekutesëve një(1)

Përshkrimi shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

-Organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve në barnatoren dhe deponë qendore të QKMF-ës;

-Përpilimi dhe realizimi i buxhetit vjetor për medikamente dhe material shpenzues;

-Disperizmi i medikamenteve dhe materialit shpenzues për barnatoren e QKMF-ës dhe QMF-ve;

Periudha e kontratës: një(1) vit punë provuese me mundësi vazhdimi:

-Koeficienti i pagës:7.20

Orët e punës:40 orë në javë

Kualifikimi profesional,aftësitë:

Farmacist i diplomuar-Magjistër i farmacisë

-Licenca e punës;

III.Vendi i punës:Infermier-e

Numri i ekzekutueseve dy(2)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

-Pranon dhe triazhon pacientët në QKMF;

-Përgatit pacientët gjatë vizitës;

-Kryen punët administrative të dokumenteve shëndetësore;

-Përgjigjet për participimin nga pacientët;

-Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës,patronazhit,terrenit dhe edukimit shëndetësor;

-Për punën e vet i përgjigjet kryeinfermierit.

Periudha e kontratës: Një(1) vit me mundësi vazhdimi

Koeficienti 4.80

Kualifikimi profesional, aftësitë

-Diploma e shkollës së mesme të mjekësisë;

-Licenca e punës;

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit të dhe certifikatën e lindjes, Licencën,të jenë banor të Republikës së Kosovës,mos të kenë fletëparaqitje penale dhe i dënuar , certifikatën shëndetësore.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Drejtorinë për Shëndetësi (zyra numër 11),nr. i tel. 028-572-115.

Mirëpritet aplikimi prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës Kosovës.

Drejtori i DSHMQS
Abdullah Klinaku